

PROFILI I PËRGJITHSHËM

Udhëzime për vlerësimin

Kjo është një skemë qortimi, në të cilën jepen disa orientime lidhur me vlerësimin e përgjigjeve të nxënësit.

- Testi përbëhet nga dy pjesë: një në prozë dhe një në dramë.
- Testi përmban një total prej **50 pikësh**.
- Testi ka 21 kërkesa.

Në vlerësimin e esesë duhet patur parasysh:

- Përgjigjja e nxënësit duhet vlerësuar në tërësinë e saj, për cilësinë që paraqet, për ndjeshmërinë, mendimin, idetë që ka shprehur dhe origjinalitetin e tyre.
- Nxënësit që kanë probleme në drejtshkrim, por arrijnë të komunikojnë me shkrim një të kuptuar të qartë të pjesës letrare (të tekstit të dhënë) dhe të pyetjes, do të marrin pikët e plota për të kuptuarit. Nga ana tjetër, nxënësit që shkruajnë qartë, rrjedhshëm dhe pa gabime, por nuk dëshmojnë ndonjë të kuptuar të mirë të tekstit dhe të kërkesës, do të marrin pikë për mënyrën e shprehjes, stilin dhe saktësinë drejtshkrimore, por nuk do të vlerësohen për të kuptuarin. **Mos harroni** se ky është një provim që vlerëson **aftësitë letrare** (përgjigjen letrare) dhe **jo aftësitë gjuhësore**.
- Gabime që nuk ndikojnë në cilësinë e përgjithshme të përgjigjes nuk do të merren në konsideratë në vlerësim. Do të hiqen pikë vetëm për ato gabime që ndikojnë mbi cilësinë dhe që i gjykoni si të rënda.

PJESA I

LASGUSH PORADECI

Skema e përgjigjeve

| | |
|------------------|---------------|
| Kërkesa 1 | D |
| Kërkesa 2 | A |
| Kërkesa 3 | C |
| Kërkesa 4 | A |
| Kërkesa 5 | D |
| Kërkesa 6 | 4 pikë |

2 pikë Foljet që tregojnë lëvizje: Venë - e - vinë - e venë, nditen, vete, vin, ndjek, lozin, shtënë, sillej.

Nxënësi do të marrë një pikë nëse shkruan **vetëm një folje** që tregon lëvizje.

0 pikë Nëse nuk gjen asnjë folje ose foljet e gjetura nuk tregojnë lëvizje.

1 pikë Po. Përdorimi është i qëllimshëm, sepse jep imazhin e lëvizjes, vërtitjes, një lloj energjie, të shkëputjes nga toka etj.

Nxënësi merr një pikë nëse në përgjigjen e tij i përmbahet idesë së dhënë më sipër.

Nëse mbron idenë e kundërt, ai do të marrë një pikë vetëm, nëse arrin ta argumentojë se pse nuk është i tillë.

0 pikë Nëse nuk jep asnjë arsye për zgjedhjen që ka bërë ose nuk përgjigjet fare.

1 pikë Po, ndikon në ritmin e poezisë duke krijuar harmoni ritmike

(krijohet ideja e valles, e lëvizjes rrethore), në bazë të së cilës është aliteracioni.

0 pikë Nëse nuk i përmbahet idesë së mësipërme ose nuk përgjigjet fare.

Kërkesa 7 3 pikë

Model përgjigjeje

Disa nga tiparet e lirikës së Lasgushit janë:

- dashuria si forcë universale, që mban të lidhur njerëzit në tokë ashtu si yjet në kozmos.

Skemat e qortimit të testeve, letërsi sesioni I

- dashuria si ndjenjë bipolare, si *liri dhe robëri, si gaz e helme, bukuri e llaftari*.
- moderniteti
- muzikaliteti i vargut,
- simbolika
- ndikimi nga folklori (opsionale, nga tërë lirika e Poradecit)
- shkëputja kohore dhe fizike nga objekti i dashurisë, papërcaktueshmëria e figurës së vashës,
- përqëndrimi më shumë te ndjenja (forca, intensiteti) e dashurisë sesa te vasha.
- malli si tipar i pandarë i dashurisë.
- fshehtësia
- struktura rrethore

3 pikë nëse përmend tre nga tiparet e përmendura më sipër.

2 pikë nëse përmend vetëm dy prej tyre.

1 pikë nëse përmend vetëm një.

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, përmend tipare që nuk i përmban lista e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit i gjykon si të sakta.

Kërkesa 8 4 pikë

Model përgjigjeje: *as fillim as fund/ Yll i mjerë e yll i lum!/ Yll i lum e yll i mjerë!/ dashuri...durim/ liri..robëri/ kudo janë e kudo s'janë.*

3 pikë nëse përmend tri nga çiftet antonimike të dhëna më sipër.

2 pikë nëse përmend vetëm dy çifte antonimike.

1 pikë nëse përmend vetëm një çift antonimik.

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

1 pikë arsyeja e përdorimit është: bipolariteti dhe kompleksiteti i ndjenjës.

Ose krijon idenë e tërheqje së të kundërtave në dashuri

Ose krijon idenë e pafundësisë kozmike

Ose krijon tërësinë e spektrit të ngjyrave ndjesore.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, përmend arsye që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon si të sakta.

Kërkesa 9 3 pikë

1 pikë Krahasimi: *si fëngjill ose posi yll margaritari!...* etj

1 pikë Simboli: *yjtë, ylli, vallja*, etj

1 pikë Roli i aliteracionit. Përsëritja e bashkëtingëlloreve: *s, n, d, r, p* krijon ndjesinë e vezullimit, të ndriçimit, të feksjes së yjeve ku është sublimuar intensiteti i dashurisë.

Ose krijon muzikalitet, i drejtohet veshit për të dhënë një imazh të caktuar, atë të forcës së dashurisë, ngarkesës së saj emocionale Do të pranohen si të sakta edhe përgjigje të tjera, që gjykohen si të tilla nga komisioni i vlerësimit.

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Kërkesa 10 6 pikë

Për pyetjen ese do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: IDEJA DHE ARGUMENTIMI

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- e ka kuptuar qartë idenë kryesore të tekstit të dhënë (fragmentit).
- përcakton teknikat e përdorura nga autori për të arritur efekte të caktuara artistike.
- interpreton në mënyrë analitike pjesën.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga teksti i dhënë.

KRITERI II: ORGANIZIMI I PËRGJIGJEVE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen.
- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

KRITERI III: SAKTËSIA DREJTSHKRIMORE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- ka saktësi drejtshkrimore.
- përdor si duhet shkronjën e madhe.
- përdor si duhet shenjat e pikësimit.

PJESA II

HEMINGUEJ – PLAKU DHE DETI

| | |
|-------------------|---------------|
| Kërkesa 11 | D |
| Kërkesa 12 | A |
| Kërkesa 13 | C |
| Kërkesa 14 | D |
| Kërkesa 15 | B |
| Kërkesa 16 | 4 pikë |

Model përgjigjeje

- Plaku Santiago është simbol i njeriut të paepur para vështirësive, stoik, plot vendosmëri për të arritur fitoren.
- Ai ka besim në forcat e veta. Ai nuk pajtohet lehtë me disfatën dhe është plot shpresë.
- Plaku është humanist. (*Keq më vjen shumë, o peshk...*).
- Simbolizon përvojën e njeriut për të përballuar vështirësitë e jetës.
- Etj

2 pikë Nëse jep portretin e figurës së Santiagos, duke dëshmuar se e ka kuptuar thelbin e saj (humanist, stoik, burrëror, me përvojë)

1 pikë Ilustrimet për të mbështetur idenë e tij.

1 pikë Jo, nuk ka kuptim. Deti është jeta e tij, toka e tij. Jeta e tij është e realizuar dhe merr kuptim vetëm në det. Atje janë fitoret dhe humbjet e tij.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim (nuk ka kuptuar thelbin e veprës) ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi është i lirë në interpretim, por në secilin rast duhet ta argumentojë qëndrimin e vet.

Kërkesa 17 3 pikë

Model përgjigjeje

- Teoria e ajsbergut (nënteksti)
- Lakonizmi
- Gjuha e thjeshtë
- Rrëfimi i rrjedhshëm
- Simbolika
- Shtresimi filozofik
- Etj.

1 pikë nëse gjen një nga veçoritë e mësipërme të stilit.

2 pikë interpretimi është i lirë, por nxënësi duhet të tregojë se di të shpjegojë qartë funksionin e një prej teknikave të mësipërme. Nxënësi do të marrë një pikë nëse interpretimi nuk është i plotë ose ka pasaktësi.

Kërkesa 18 4 pikë

Model përgjigjeje

Simbole: plaku, deti, peshku, peshkaqenët, varka, etj.

Interpretimi: Plaku simbolizon përvojën njerëzore, luftën për ekzistencë, stoicizmin, mëcurinë, etj.

Deti simbolizon rrjedhën e jetës, me gjithë dallgëzimet, të papriturat, rreziqet por dhe çastet e bukura, të qeta, etj.

Peshkaqenët simbolizojnë rreziqet në jetë, të papriturat, armiqësitë që e rrethojnë njeriun, pabesinë, por edhe çastet kulmore ku fitoret përmbysen nga disfatat, etj.

2 pikë nëse gjen dy simbole nga ato të dhëna më sipër (ose edhe ndonjë tjetër)

2 pikë nëse interpreton secilin simbol. Nxënësit janë të lirë në interpretimet që do të japin, por duhet të tregojnë se dinë t'i zbërthejnë simbolet në mënyrë të qartë dhe të saktë.

Kërkesa 19 3 pikë

Model përgjigjeje

- Plaku është peshkatar me përvojë dhe deti është jeta e tij. Ai e ka kaluar pjesën më të madhe të jetës në det dhe është e natyrshme që ai të jetë bërë pjesë e pandarë e tij. Deti është edhe miku i tij, shoku i jetes së tij. Në ditët e gjata të lundrimit, kur përreth ka vetëm një masë të paanë uji, mik i vetmisë së tij të bëhet deti. Ndaj është mëse e natyrshme që ai të flasë, të dialogojë dhe pse jo edhe të shprehë meditime, ku derdhet përvoja e tij e gjatë. Të gjitha këto ne, lexuesit, që ndoshta e njohim pak këtë lloj jete, i perceptojmë si konkluzione filozofike.

Ose

- Çdo njeri, aq më tepër një njeri me përvojë si plaku Santiago, është e natyrshme që në momente kulmore, të vështira, delikate, të meditojë të dialogojë në formë filozofike.

Ose

- Një vepër me një hero kryesor, është e natyrshme që të përmbajë shtresën meditative. Personazhi duke mos pasur se me kë të dialogojë, flet me veten në formë dialogo dhe monologu, të cilat përmbajnë shtresën filozofike.

1 pikë Nuk e tepron, është plotësisht e qëllimshme.

2 pikë Interpretim i lirë. Nxënësi tregon se e ka kuptuar qartë thelbin se pse filozofon Santiago. Përgjigjja e tij mund të jetë fokusuar në një nga drejtimit e dhëna më sipër ose mund të jetë edhe një interpretim krejtësisht i ndryshëm, por i argumentuar dhe mjaft i qartë.

Kërkesa 20 6 pikë

Për pyetjen ese do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: IDEJA DHE ARGUMENTIMI

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- e ka kuptuar qartë idenë kryesore të tekstit të dhënë (fragmentit).

Matura Shtetërore 2006, Teste

- përcakton teknikat e përdorura nga autori për të arritur efekte të caktuara artistike.
- interpreton në mënyrë analitike pjesën.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga teksti i dhënë.

KRITERI II: ORGANIZIMI I PËRGJIGJEVE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen.
- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

KRITERI III: SAKTËSIA DREJTSHKRIMORE

2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- ka saktësi drejtshkrimore.
- përdor si duhet shkronjën e madhe.
- përdor si duhet shenjat e pikësimit.